L I G J
Nr. 8673, datë 26.10.2000

PËR RATIFIKIMIN E AMENDAMENTIT TË "MARRËVESHJES SË KREDISË", NËNSHKRUAR NË 7 MARS 1994, NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, PËRFAQËSUAR NGA KOMITETI QEVERITAR PËR BORXHIN E JASHTËM DHE ERSTE BANK DER OESTERREICHISCHEN SPARKASSEN AG (ISH-GIROCREDIT)

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
V E N D O S I :

Neni 1

Ratifikohet amendamenti i "Marrëveshjes së kredisë", nënshkruar në 7 mars 1994, ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Komiteti Qeveritar për Borxhin e Jashtëm dhe Erste Bank Der Oesterreichischen Sparkassen AG (ish-Girocredit).

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr. 2777, datë 3.11.2000, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani.

AMENDAMENT

i Marrëveshjes së Kredisë së 7 Marsit 1994

ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Komiteti Qeveritar Shqiptar për Borxhin e Jashtëm dhe Erste Bank der Osterrreichschen Sparkassen AG (ish-GiroCredit), që vepron për dhe në emër të tij, por sipas udhëzimeve të Osterreichische Kontrollbank Aktiengesellschaft, Viene/Austri, i cili nga ana e tij vepron si agjent i Republikës së Austrisë, në përputhje me Export Guarantees Act 1981

1. OBJEKTI I AMENDAMENTIT

Objekt i këtij Amendamenti është shtyrja e disa shumave të borxheve që kanë lindur sipas Marrëveshjes së Kredisë së 7 Marsit 1994.

Ky Amendament përbën një pjesë të pandarë të Marrëveshjes së kredisë të 7 Marsit 1994 dhe nuk e përjashton atë, klauzolat e së cilës mbeten në fuqi të plotë pasi nuk ndryshojnë dhe nuk preken nga ky Amendament.

2. SHUMAT E SHTYRA

A. 100% e shumave të principalit dhe interesit (përfshirë interes-vonesat) që duheshin paguar deri më 31 Mars 1999 dhe që nuk janë paguar dhe 100% e shumave të principalit dhe interesit (pa interes-vonesat) që duhen paguar nga 1 Prilli 1999 deri më 30 Qershor 2000 (përfshirë) dhe që nuk janë paguar, shuma që rrjedhin nga Llogaria e Marrëveshjes së kredisë të 7 Marsit 1994 (neni IV, paragrafi 4.01).

DATA E MATURIMIT PRINCIPALI NE EUR. INTERESI NË EUR.

30.12.1999		37,212.90
31.12.1999	839,767.67	
31.12.1999		39,037.07
31.03.2000		29,803.35
30.06.2000	1,007,721.21	
30.06.2000		31,586.46

A. 100% e interesit që nga 1 Prilli 1999 deri më 30 qershor 2000 (përfshirë) i llogaritur mbi shumat e shtyra në bazë të përqindjes së interesit të përcaktuar në Nenin III të Marrëveshjes së Kredisë të 7 Marsit 1994, do të kapitalizohet në 30 Qershor 2000.

B. Shuma e përgjithshme e shumave të shtyra nuk do t'i kalojë 2,100,000.00 EUR (kundërvlefta e 28,896,630.00 ATS).

3. TERMAT E RIPAGESËS

Ripagesa e shumave të shtyra të përmendura në Nenin 2.A. dhe B. do të bëhet në 10 këste të barabarta gjashtëmujore :

30 Qershor 2001	31 Dhjetor 2001
30 Qershor 2002	31 Dhjetor 2002
30 Qershor 2003	31 Dhjetor 2003
30 Qershor 2004	31 Dhjetor 2004
30 Qershor 2005	31 Dhjetor 2005

4. INTERESI QË DO TË PAGUHET

Duke filluar nga 30 Qershori 2000, interesi mbi shumat e shtyra, siç theksohet në Nenin 2.A. dhe B., i llogaritur sipas përqindjes së interesit të përcaktuar në Nenin III të Marrëveshjes së Kredisë së 7 marsit 1994, do të paguhet çdo tre muaj në datat e pagesës së interesit 31 Mars, 30 Qershor, 30 Shtator dhe 31 Dhjetor të çdo viti, data e parë e pagesës së interesit është 30 Shtator 2000.

5. DETYRIMET E HUAMARRËSIT PËR PAGESAT

Gjatë periudhës tranzitore të futjes së EUROS, nga 1 Janari 1999 deri më 31 Dhjetor 2001, të gjitha pagesat mund të kryhen ose në shilinga austriake ose në EURO. Që nga 1 Janari 2002, të gjitha pagesat do të kryhen vetëm në EURO.

Ky Amendament është bërë në dy kopje origjinale në gjuhën angleze, nga një për secilën palë.

Tiranë, më 24.7.2000	Vienë, më 30.3.2000
PËR REPUBLIKËN E SHQIPËRISË	PËR ERSTE BANK DER OSTERREICHISCHEN SPARKASSEN AG